


STRUKTURA DPPM



ORGANIKA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PATENTAVE DHE MARKAVE

<i>POZICIONI</i>	<i>KATEGORIA</i>	<i>NUMRI</i>
I. DREJTOR I PËRGJITHSHËM		<u>(1)</u>
SEKRETAR		1
II. DREJTORIA E EKZAMINIMIT		<u>(10)</u>
DREJTOR		1
SEKTORI I PATENTAVE		<u>(4)</u>
PËRGJEGJES SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	3
SEKTORI I MARKAVE, DISENJOVE DHE TREGUESVE GJEOGRAFIKE		<u>(5)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST	IV-a	4
III. DREJTORIA E KOORDINIMIT, PROMOVIMIT DHE TRAJNIMEVE		<u>(5)</u>
DREJTORI		1
SPECIALIST	IV-a	4
IV. SEKTORI JURIDIK		<u>(3)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a /1	1
SPECIALIST	IV-a	2
V. SEKTORI I FINANCËS, SHËRBIMEVE DHE PUBLIKIMEVE		<u>(4)</u>
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
SPECIALIST IT	IV-a	1
SPECIALIST	IV-a	1
<u>PROTOKOLL</u>		1
PUNONJËS GJITHSEJ		<u>24</u>

PËRSHKRIMI I PUNËS SË PUNONJËSVE QË KËRKOHEN TË SHTOHEN OSE TË NDRYSHOHEN NË STRUKTURËN E DPPM-së

I. SEKTORI JURIDIK

Detyrat e specialistit të sektorit juridik.

Specialisti i Sektorit Juridik i quajtur specialist jurist i cili duhet të jetë jurist, ka si objekt të veprimtarisë së tij detyrat e mëposhtme:

1.1 Specialisti i Sektorit Juridik është në varësinë e drejtpërdrejtë të përgjegjësit të Sektorit Juridik dhe zbaton me përpikmëri detyrat e ngarkuara prej tij.

1.2 Harton progres raportet periodike për çështjet e Pronësisë Industriale të cilat u adresohen komiteteve dhe nënkomiteteve të integrit Shqipëri-BE.

1.3 Mban korrespondencë me zyrtarë ndërkombëtarë të patentave dhe markave në përputhje me parashikimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të fushës në të cilat Shqipëria është shtet anëtar.

1.4 Ndjek çështjet gjyqësore me objekt shkeljen e të drejtave të Patentave, Markave, Disenjove, Treguesve gjeografikë nga subjektet në treg ku DPPM thirret si palë.

1.5 Me miratim të përgjegjësit të sektorit i ofron asistencë dhe ndihmë juridike punonjësve të DPPM-së sa herë që i kërkohet duke dhënë mendime juridike dhe duke përpiluar shkresa dhe akte të tjera administrative në bashkëpunim me stafin.

1.6 Me miratim të përgjegjësit të sektorit përgatit në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit, njoftimet për Zyrën Ndërkombëtare në rastet e refuzimit, zhvlerësimit, pavlefshmërisë ose kundërshtimeve të depozituara për markat ndërkombëtare.

1.7 Me miratim të përgjegjësit të sektorit merr pjesë dhe asiston në hartimin e planit të aktiviteteve promovuese dhe trainuese të Pronësisë Industriale në vendin tonë.

1.8 Përgatit informacionin e nevojshëm për përditësimin e faqes së internetit në lidhje me ndryshimet e bazës ligjore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare të fushës.

1.9 Paraqet sygjerimet për programet e punës në rast seminari apo takimi me grupet e interesit, përfaqësuesit e autorizuar apo ekspertët e huaj.

1.10 Asiston përgjegjësin e sektorit në përmbushjen e detyrave dhe objektivave të sektorit.

1.11 Kryen detyra të tjera që i caktohen nga përgjegjësi i sektorit .

II.DREJTORIA E EKZAMINIMIT

1. Kompetencat dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Ekzaminimit.

Drejtori i Drejtorisë së Ekzaminimit është në varësinë e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe ka si objekt të veprimtarisë së tij detyrat e mëposhtme:

1.1 Kontrollon dhe miraton planet e propozuara nga përgjegjësit e sektorëve në varësi të tij për përmirësimin e praktikave të punës së sektorëve.

1.2 Kontrollon punën e sektorëve në varësi të tij, firmos aktet administrative të lëshuara nga këta sektorë në përmbushje të detyrave funksionale, nqs është e nevojshme bën veprimet në IPAS dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm për mbarëvajtjen e punës në këta sektorë.

1.3 Në bashkëpunim me Drejtorin e Koordinimit, Promovimit dhe Trainimeve të DPPM-së, merr pjesë në studimin dhe hartimin e planit strategjik të koordinimit institucional, si dhe me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm, ndjek e merr masa për realizimin e objektivave që përcaktohen në të.

1.4 Përgatit, mbikqyr dhe miraton materialet e përgatitura nga Përgjegjësit e Sektorëve në varësi, në lidhje me temat që do të trajtohen në seminare, trainime dhe konferenca.

1.5 Paraqet propozime Drejtorit të Koordinimit, Promovimit dhe Trainimeve për hartimin e planit të programeve dhe kualifikimit të punonjësve të DPPM.

1.6 Paraqet propozime te Drejtori i Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve për nevojën e aktiviteteve promovuese dhe trainuese të Pronësisë Industriale në vendin tonë.

1.7 Organizon dhe mbikëqyr drejtimin, kooperimin dhe bashkëveprimin e punës ndërmjet sektorëve në vartësi, zgjidhjen e problemeve të dala dhe kërkon llogari për zbatimin e detyrave.

1.8 Koordinon drejton dhe ndjek hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm dhe afatgjatë të koordinimit strategjik të sektorëve në varësinë e tij, konform detyrave dhe angazhimeve të përcaktuara në të.

1.9 Bashkërendon punën dhe miraton raportet 6-mujore dhe vjetore të punës të hartuar nga Përgjegjësit e Sektorëve në varësi dhe harton planin e punës së Drejtorisë së Ekzaminimit për vitin e ardhshëm dhe ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm.

1.10 Mbikqyr përmbushjen e detyrave nga përgjegjësit e sektorëve në varësi të tij, bën vlerësimin e punës së tyre dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm për shpërblimet, vlerësimet apo masat disiplinore për ta në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. SEKTORI I PATENTAVE

Detyrat e specialistit të rregjistrimit të patentave në sektorin e Patentave

Specialisti i Sektorit të Patentave i quajtur “specialist i rregjistrimit të Patentave”, i cili preferohet të ketë diplomë në Shkencat e Natyrës, ka si objekt të veprimtarisë, brenda pozicionit të tij të punës, ekzaminimin aplikimeve për transferim pronësie, regjistrim kontrate license, ndryshim emri ose adrese të pronarit të patentës, hetim patente, korrigjime në patentë, dorëheqje nga patenta, ekzaminimin e aplikimeve për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e patentave, modeleve të përdorimit dhe regjistrin e topografive të qarqeve të integruara.

Në përmbushjen e kësaj veprimtarie, ekzaminuesi i patentave kryen detyrat e mëposhtme:

- 2.1 Merr në dorëzim nga protokolli dosjet e aplikimeve, për transferim pronësie, regjistrim kontrate license, ndryshim emri ose adrese të pronarit të patentës, hetim patente, korrigjime në patentë, dorëheqjes nga patenta, dhe aplikimeve të tjera që kanë lidhje me patentat të cilat i janë caktuar atij, shqyrton nëse dokumentacioni që përmban aplikimi plotëson kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij dhe në varësi të rezultatit të shqyrtimit, përpilon të gjitha aktet administrative të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij.
- 2.2 Merr në dorëzim nga zyra e protokollit dhe shqyrton dokumentat plotësuese të aplikimit të dorëzuara nga aplikanti me iniciativën e tij ose kur kjo i është kërkuar me anë të një njoftimi zyrtar nga DPPM, si dhe verifikon afatet e dorëzimit të tyre.
- 2.3 Shqyrton nëse dokumentacioni që përmban aplikimi përmbush kërkesat e Ligjit dhe të rregulloreve dalë në zbatim të tij si dhe verifikon nëse tarifat e paguara nga aplikanti janë në përputhje me VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.
- 2.4 Verifikon nëse të dhënat e hedhura në database-in e DPPM (IPAS) për aplikimin që i është caktuar atij për ekzaminim janë të sakta dhe bën korrigjimin e tyre nëse është e nevojshme.
- 2.5 Kryen të gjitha veprimet e parashikuara në IPAS për ekzaminimin e aplikimit që i është caktuar atij.
- 2.6 Gjatë shqyrtimit të aplikimeve të përmendura më lart, specialisti i rregjistrimit mban përgjegjësi për respektimin e afateve ligjore dhe ndjekjen me përpikmëri të procedurave të ekzaminimit të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij.

- 2.7 Specialisti i regjistrimit mban përgjegjësi për ligjshmërinë e akteve administrative të përpiluara prej tij gjatë ekzaminimit të aplikimeve që i janë caktuar atij.
- 2.8 Specialisti i regjistrimit i përpilon aktet administrative të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij në dy kopje, nga të cilat njëra depozitohet në dosje dhe kopja tjetër dorëzohet nga ekzaminuesi në zyrën e protokollit të DPPM.
- 2.9 Raporton me shkrim para Përgjegjësit të Sektorit të Patentave për punën e kryer prej tij, sa herë që i kërkohet.
- 2.10 Shqyrton kërkesat për hetim të depozituara pranë DPPM nëse janë në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij, kryen hetimet për patentat, modelet e përdorimit si dhe përpilon aktin për përgjigjen e hetimit.
- 2.11 Specialisti i regjistrimit është përgjegjës për vendosjen dhe sistemimin e fletëve të regjistrimit në regjistrin e patentave, si edhe administrimin e arkives dhe regjistrimit të patentave.
- 2.12 Hap faqet e reja të regjistrimit për patentat, modelet e përdorimit si edhe të regjistrimit të topografive të qarqeve të integruara që regjistrohen.
- 2.13 Hedh në faqen përkatëse të regjistrimit të gjitha ndryshimet që pëson një patentë, model përdorimi, topografive të qarqeve të integruara sipas rendit kronologjik të tyre.
- 2.14 Shqyrton kërkesat për lëshim ekstrakti nga regjistrat për patentat, modelet e përdorimit si edhe të regjistrimit të topografive të qarqeve të integruara të depozituara pranë DPPM nëse janë në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij, dhe përpilon dokumentin e ekstraktit të regjistrimit.
- 2.15 Merr në dorëzim dosjet nga ekzaminuesit e patentave, pasi kontrollon përmbajtjen e dosjes sipas indeksit si dhe plotëson në të pjesën që i takon Specialistit të regjistrimit dhe dosjet e aplikimeve të përfunduara.
- 2.16 Merr në dorëzim nga ekzaminuesit e patentave, dokumentacionin për ripërtëritje të patentave së bashku me vendimin përkatës dhe regjistron pagesën dhe të dhënat e tjera në indeksin e dosjes për ripërtëritje të patentës në arkivë, dhe e arkivon atë në dosjen përkatëse.
- 2.17 Kryen veprimet për evidentimin dhe pranimin e dokumentave të sjella nga ekzaminuesit e patentave.
- 2.18 Përgatit listën e veçimit të dokumentave të arkivës për të cilat kanë kaluar afatet e ruajtjes.
- 2.19 Shqyrton kërkesat për lëshim dublikate nga dosjet e patentave modeleve të përdorimit dhe qarqeve të integruara, nëse janë në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij, dhe përpilon aktin për lëshimin e dublikatës.

- 2.20 Specialisti i ngarkuar për mbajtjen e regjistrit dhe administrimin e arkivës së patentave, mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e akteve të përpiluara prej tij.
- 2.21 Inspektimi i regjistrave dhe dosjeve të patentave, modeleve të përdorimit, qarqeve të integruara dhe dosjeve të aplikimeve të dorëzuara në arkivë si dhe fotokopjimi i tyre bëhet vetëm me autorizim me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPM.
- 2.22 Kryen detyra të tjera që i caktohen nga përgjegjësi i sektorit.

3. SEKTORI I MARKAVE, DISENJOVE DHE TREGUESVE GJEOGRAFIKË

Detyrat e Specialistit të Markave të regjistruara nga Marrëveshja dhe Protokoli i Madridit.

Specialisti i Sektorit të Markave i quajtur “egzaminues i Markave të Madridit”, i cili preferohet të jetë i diplomuar për ekonomik ose juridik, ka si objekt të veprimtarisë, brenda pozicionit të tij të punës, ekzaminimin e aplikimeve të Markave të regjistruara nga Marrëveshja dhe Protokoli i Madridit.

Në përmbushjen e kësaj veprimtarie, ekzaminuesi i Markave të Madridit kryen detyrat e mëposhtme:

- 3.1 Merr në dorëzim nga zyra e protokollit dhe ekzaminon aplikimet e sjella nga WIPO.
- 3.2 Në varësi të rezultatit të ekzaminimit për bazat absolute për refuzim, njofton përgjegjësin e Sektorit në rastet kur aplikimi nuk përmbush kërkesat e nenit 142 të ligjit si dhe lëshon njoftim për sektorin juridik i cili ndjek procedurat me WIPO-n.
- 3.3 Ekzaminuesi i Markave të regjistruara nga Marrëveshja dhe Protokoli i Madridit mban përgjegjësi për ligjshmërinë e akteve administrative të përpiluara prej tij gjatë ekzaminimit të aplikimeve ndërkombëtare.
- 3.4 Kryen të gjitha veprimet e parashikuara në IPAS për ekzaminimin e aplikimit që i është caktuar atij.
- 3.5 Bën në IPAS veprimet e parashikuara për ndryshimet në emër adresë, klasë dhe ripërtëritje për aplikimet e markave të Madridit.
- 3.6 Gjatë shqyrtimit të aplikimeve të përmendura më lart, ekzaminuesi i markave mban përgjegjësi për respektimin e afateve ligjore të parashikuara në Marrëveshjen dhe Protokollin e Madridit.

- 3.7 Ekzaminuesi i Markave të regjistruara nga Marrëveshja dhe Protokolli i Madridit i përpilon njoftimet në dy kopje, nga të cilat njëra depozitohet në dosje dhe kopja tjetër i dorëzohet Sektorit Juridik nëpërmjet zyrës së protokollit të DPPM.
- 3.8 Raporton me shkrim para përgjegjësit të Sektorit të Markave për punën e kryer prej tij, sa herë që i kërkohet.
- 3.9 Sistemon aplikimet në dosjet përkatëse sipas praktikave të sjella nga WIPO duke i ndarë ato në aplikime të reja, ndryshime në emër, pronësi dhe adresë.
- 3.10 Mban një kopje të fletës shoqëruese të aplikimve të sjella nga WIPO për efekt korespondence.
- 3.11 Përgatit në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit, njoftimet për Zyrën Ndërkombëtare në rastet e refuzimit, zhvlerësimit, pavlefshmërisë ose kundërshtimeve të depozituara për markat ndërkombëtare dhe ja paraqet Përgjegjësit të Sektorit.
- 3.12 Kryen detyra të tjera që i caktohen nga përgjegjësi i sektorit .

III. DREJTORIA E KOORDINIMIT, PROMOVIMIT DHE TRAJNIMEVE

Drejtorja ka si objektiv kryesor të veprimtarisë së tij, të promovojë Pronësisë Industriale në vendin tonë për ndërgjegjesimin e publikut dhe grupeve të interesit, si dhe institucionet e përfshira në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale me qëllim forcimin e këtij sistemi nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të trajnimit dhe promovimit në fushën e të drejtave të Pronësisë Industriale.

Detyrë tjetër kryesore është edhe koordinimi i hartimit të planit të punës me organizmat e huaja në të cilat Shqipëria është vend anëtar.

1. Kompetencat dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve.

Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve është në varësinë e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe ka si objekt të veprimtarisë së tij detyrat e mëposhtme:

1.1 Kontrollon punën dhe miraton projektet dhe planet e propozuara nga përgjegjësit e sektorëve në varësi të tij për përmirësimin e praktikave të punës së sektorëve.

1.2 Menaxhon dhe ndjek programet dhe veprimtarinë e projekteve nga grantet e huaja, të donatorëve etj.

1.3 Në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë së Ekzaminimit të DPPM-së, merr pjesë në studimin dhe hartimin e planit strategjik të koordinimit institucional, si dhe me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm, ndjek e merr masa për realizimin e objektivave që përcaktohen në të.

1.4 Koordinon dhe drejton procesin e hartimit të programeve të kualifikimit dhe trainimit të punonjësve të DPPM-së.

1.5 Drejton përgatitjen e aktiviteteve dypalëshe në fushën e pronësisë industriale me zyra homologe të vendeve të tjera si dhe në përgatitjen e aktiviteteve me institucione të tjera shqiptare në fushën e PI.

1.6 Organizon dhe drejton përgatitjen e aktiviteteve promovuese dhe trainuese të DPPM-së në fushën e Pronësisë Industriale në vend.

1.7 Harton planin periodik dhe vjetor të administrimit të projekteve nga grantet e huaja, të cilat ia paraqet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm dhe përgjigjet për të gjitha veprimet që kryen në kuadrin e administrimit të këtyre projekteve.

1.8 Ndjek dhe menaxhon dhe përfaqëson bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është shtet anëtar.

1.9 Ndjek dhe kontrollon raportet për zhvillim, informim apo ndryshim në performancën e DPPM-së të cilat dërgohen në organizma ndërkombëtarë apo dhe institucione vendase.

2.0 Monitoron punën e Specialistëve për të zhvilluar një marketing të nevojshëm për nxitjen e interesit të grupeve të targetuara.

2.1 Organizon dhe mbikëqyr, drejtimin, kooperimin dhe bashkëveprimin e punës për zgjidhjen e problemeve të dala dhe kërkon llogari për zbatimin e detyrave.

2.2 Koordinon dhe drejton hartimin, dhe ndjek zbatimin e planit afatmesëm dhe afatgjatë të koordinimit strategjik të drejtorisë konform detyrave dhe angazhimeve të përcaktuara në të.

2.3 Harton raportet 6-mujore dhe vjetore të punës së Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve për vitin e ardhshëm dhe ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm.

2.4 Mbikqyr përmbushjen e detyrave nga specialitet në varësi të tij, bën vlerësimin e punës së tyre dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm për shpërblimet, vlerësimet apo masat disiplinore për ta në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.5 Informohet në lidhje me shpenzimet dhe parashikimet buxhetore të DPPM në mënyrë që plani financiar dhe aktivitetet e Drejtorisë të realizohen në përputhje me buxhetin vjetor.

2.6 Ndjek punën për përgatitjen e materialeve për aktivitete dhe komitetet e organizatave të huaja në të cilat DPPM mer pjesë.

2.7 Mbikqyr përmbushjen e detyrave nga specialistët e Drejtorisë, bën vlerësimin e punës së tyre dhe informon Drejtorin e Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve në rastet e shkeljes së disiplinës në punë nga ana e tyre.

2.8 Kontrollon dhe miraton informacionin e përgatitur nga specialistët për përditësimin e faqes së internetit në lidhje me aktivitetin e Zyrës .

2.9 Kontrollon dhe miraton informacionin e përgatitur të materialeve informuese dhe promovuese në fushën e PI.

2.10 Monitoron performancën në Web-site çdo muaj.

2.11 Siguron përfshirjen e DPPM-së në rrjetet Sociale.

2.12 Kryen detyra të tjera që i caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

1. 3. Detyrat e specialistit të Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve.

Specialisti i Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve, ka si objekt të veprimtarisë së tij detyrat e mëposhtme:

3.1 Specialisti i Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve është në varësinë e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve dhe zbaton me përpikmëri detyrat e ngarkuara prej tij.

3.2 Merr pjesë në aktivitetet e Drejtorisë dhe harton raportin përfundimtar në lidhje me aktivitetin.

3.3 Përgatit programet e punës në bashkëpunim me sektorët e tjerë (në varësi të temave që do të trajtohen) në rast seminari apo takimi me grupet e interesit, përfaqësuesit e autorizuar apo ekspertët e huaj.

3.4 Asiston Drejtorin e Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve në përmbushjen e detyrave dhe objektivave të sektorit.

3.5 Merr pjesë dhe asiston në hartimin e planit të aktiviteteve promovuese dhe trainuese të Pronësië Industriale në vendin tonë.

3.6 Ndhmon në përgatitjen e aktiviteteve dypalëshe në fushën e Pronësisë Industriale me zyra homologe të vendeve të tjera si dhe në përgatitjen e protokolleve të bashkëpunimit me institucione të tjera shqiptare në fushën e PI.

3.7 Përgatit informacionin e nevojshëm për përditësimin e faqes së internetit në lidhje me aktivitetin e Zyrës.

3.8 Ndjek të gjitha dokumentat e publikuara nga WIPO, EPO, OHIM dhe organizata të tjera ku DPPM bën pjesë dhe përgatit e materialet dhe raportet informuese për eprorët .

3.9 Monitoron përfshirjen e DPPM-së në rrjetet Sociale

4.0 Formaton Buletinin e Pronësisë Industriale me të dhënat e dërguara nga Specialisti i IT

4.1 Mundëson fotokopjimin apo shumëfishimin e materialeve të ndryshme kur i kërkohet.

4.2 Kryen detyra të tjera që i caktohen nga Drejtori i Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve.

IV. SEKTORI I FINANCËS SHËRBIMEVE DHE PUBLIKIMEVE

Detyrat e Specialistit të sektorit të financës shërbimeve dhe publikimeve

Specialisti i Sektorit të financës, shërbimeve dhe publikimeve i cili preferohet të ketë profil në fushën e Informatikës Ekonomike, ka si objekt të veprimtarisë së tij detyrat e mëposhtme:

2.1 Është në varësi të drejtpërdrejtë të përgjegjësit të Sektorit të financës, shërbimeve dhe publikimeve dhe përgjigjet para tij për realizimin e detyrave të ngarkuara.

2.2 Hedh në sistemin IPAS të gjitha të dhënat e aplikimeve të markave që duhet të jenë në format elektronik.

2.3 Hedh në sistemin IPAS të gjitha të dhënat e aplikimeve të patentave që duhet të jenë në format elektronik.

2.4 Hedh në sistemin IPAS të gjitha të dhënat e aplikimeve të disenjove industriale që duhet të jenë ne format elektronik.

2.5 Hedh në sistemin IPAS të gjitha të dhënat e aplikimeve të treguesve gjeografikë që duhet të jenë ne format elektronik.

2.6 Skanon pamjet e markave dhe disenjove, si edhe skanon të gjithë dokumentacionin e depozituar në protokoll, dhe i kalon në sistemin IPAS.

2.7 Mundëson kalimin në format elektronik.

2.8 Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga përgjegjësi i Sektorit të financës, shërbimeve dhe publikimeve.

V. SEKRETAR

1. Detyrat e sekretarit

Sekretari është në varësinë e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe ka si objekt të veprimtarisë së tij detyrat e mëposhtme:

- 1.1 Ndjek dhe koordinon protokollin e takimeve zyrtare që zhvillohen në drejtori.
- 1.2 Koordinon takimet e Drejtorit të Përgjithshëm me përfaqësuesit e institucioneve homologe dhe me përfaqësuesit e organizmave ndërkombëtare
- 1.3 Administron shkresat, postën dhe postën elektronike të Drejtorit të Përgjithshëm.
- 1.4 Administron axhendën, takimet administrative të Drejtorit të Përgjithshëm.
- 1.5 Administron telefonatat, kontaktet me partnerët,.
- 1.6 Kryen detyrat e ndryshme funksionale të nevojshme për administrimin e zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm që mund të paraqiten rast pas rasti.
- 1.7 Raporton para Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e detyrave sa herë që i kërkohet.
- 1.8 Merr pjesë në mbledhjet e Drejtorisë dhe mban shënimet e mbledhjes.
- 1.9 Kryen detyra të tjera që i caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE**

URDHËR

Nr 691 datë 21/08/2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË PATENTAVE DHE MARKAVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe të nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 191 pika 4 të ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale":

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores së Brendshme "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave", sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

FLORJON MIMA

RREGULLORE E BRENDSHME

“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PATENTAVE DHE MARKAVE”

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Statusi juridik

1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) është institucion publik në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë.

1.2 Aktiviteti i DPPM përcaktohet dhe rregullohet nga:

- a) Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, megjithë ndryshimet e mëvonshme, i quajtur më poshtë “Ligji”;
- b) Ligji Nr. 8488, datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara” ndryshuar me Ligjin Nr. 9957 datë 07.07.2008, megjithë ndryshimet e mëvonshme;
- c) VKM Nr.1707 datë 29/12/2008 “Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave të shpikjeve dhe modeleve të përdorimit”, megjithë ndryshimet e mëvonshme;
- ç) VKM Nr. 1706 datë 29/12/2008 “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit”, megjithë ndryshimet e mëvonshme;
- d) VKM Nr.381 datë 08.04.2009 “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e disenjove industriale”, megjithë ndryshimet e mëvonshme;
- dh) VKM Nr.1705 datë 29/12/2009 “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e treguesve gjeografikë”, megjithë ndryshimet e mëvonshme;
- e) VKM Nr.883 datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, megjithë ndryshimet e mëvonshme;
- ë) Marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale në të cilat Republika e Shqipërisë është shtet anëtar.

1.3 DPPM drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili është autoriteti i vetëm drejtues dhe vendimmarrës në institucion. Drejtori i Përgjithshëm i DPPM emërohet dhe lirohet nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

1.4 Struktura dhe organika e DPPM përcaktohet me urdhër të Kryeministrit me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës.

1.5 DPPM ka vulën e saj të cilën e përdor në korrespondencën zyrtare me palët e treta.

2. Misioni i DPPM

2.1 Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave ka si mision të garantojë mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale në territorin shqiptar, nëpërmjet njohjes dhe/ose regjistrimit të këtyre të drejtave si dhe administrimit të regjistrave të objekteve të pronësisë industriale.

2.2 Objektet e pronësisë industriale janë: shpikjet, modelet e përdorimit, disenjot industriale, markat tregtare dhe të shërbimit dhe treguesit gjeografikë. DPPM njeh dhe regjistron gjithashtu të drejtat mbi topografitë e qarqeve të integruara.

3. Objektivat

3.1 DPPM e përmbush misionin e saj nëpërmjet zbatimit të objektivave të mëposhtme:

- a) ndërmarrja e iniciativave për përmirësimin e legjislacionit në fushën e Pronësisë Industriale;
- b) ndërmarrja e iniciativave për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventa e Marrevëshje Ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Industriale;
- c) ndërmarrja e iniciativave për rritjen e bashkëpunimit midis institucioneve që bëjnë pjesë në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale;
- ç) krijimi i një sistemi efektiv të njohjes dhe regjistrimit të të drejtave të pronësisë industriale në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- d) promovimi i të drejtave të pronësisë industriale, i rolit dhe rëndësisë së respektimit të këtyre të drejtave në qarqet e biznesit dhe në grupet e tjera të interesuara;
- dh) garantimi i kapaciteteve administrative të nevojshme për realizimin e detyrave të ngarkuara me ligj.

KREU II

STRUKTURA DHE ORGANIKA E DPPM

1. Baza ligjore e organizimit të DPPM

1.1 Struktura dhe organika e DPPM është miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr.131 datë 06.11.2012 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Patentave dhe Markave”.

1.2 Struktura dhe organika e DPPM është e ndryshueshme në përputhje me nevojat për zhvillimin e kapaciteteve administrative të DPPM.

2. Struktura dhe organika e DPPM

2.1 **Drejtori i Përgjithshëm** është titullari i DPPM.

2.2 **Drejtoria e Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve** është në varësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe ka në organikën e saj:

2.2.1 **Drejtorin e Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve**

2.2.2 **Sektorin e Patentave** që ka në organikën e tij:

- a) Përgjegjësën e Sektorit;
- b) Specialistët e sektorit.

2.2.3 **Sektorin e Markave, Disenjove dhe Treguesve Gjeografikë** që ka në organikën e tij:

- a) Përgjegjësën e Sektorit;

b) Specialistët e sektorit.

2.3 Sektori i Shërbimeve është në varësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe ka në organikën e tij:

- a) Përgjegjës Sektori;
- b) Specialist IT;
- c) Arkëtar/Protokollist;

2.4 Sektori Juridik është në varësinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe ka në organikën e tij:

- a) Përgjegjës Sektori;
- b) Specialist;
- c) Specialist regjistri.

KREU III

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DPPM

1. Drejtimi i DPPM nga Drejtori i Përgjithshëm

1.1 Drejtori i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e DPPM, si dhe kontrollon dhe garanton përmbushjen e misionit dhe objektivave të drejtorisë dhe të detyrimeve që ka ky institucion në përputhje me bazën ligjore të parashikuar nga pika 1.2 e Kreut I të kësaj rregulloreje.

1.2 Drejtori i Përgjithshëm i DPPM përfaqëson drejtorinë në marrëdhëniet me të tretët si dhe autorizon personat që mund të përfaqësojnë drejtorinë në mungesë të tij.

1.3 Drejtori i Përgjithshëm drejton dhe kontrollon veprimtarinë e DPPM duke nxjerrë urdhëra, udhëzime dhe porosi me shkrim ose verbale, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga punonjësit e DPPM.

1.4 Drejtori i Përgjithshëm i DPPM ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me zyra homologe të vendeve të tjera ose me institucione shqiptare kur këto janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore që ka DPPM në fushën e pronësisë industriale.

2. Kompetencat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm

2.1 I propozon për miratim Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të DPPM si dhe ndryshimet e saj.

2.2 Shqyrton dhe i paraqet për miratim Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës çdo vit projektplanin për zhvillimin e Drejtorisë, problemet e financimit dhe të planit financiar si dhe problemet e vendeve të punës dhe çështjet sociale të lidhura me kushtet e punës së Drejtorisë.

2.3 Mbikqyr dhe koordinon hartimin e planit vjetor të veprimtarisë së DPPM nga secili sektor i saj, e miraton dhe ia paraqet atë Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2.4 I raporton Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në fund të çdo viti, lidhur me realizimin e detyrave të planit të zhvillimit, planit financiar dhe veprimtarive të tjera të Drejtorisë si dhe për çështje të tjera për të cilat kërkohen raportime nga Ministri.

2.5 Emëron dhe shkarkon nga puna punonjësit e DPPM në përputhje me parashikimet e ligjit për statusin e nëpunësit civil ose të Kodit të Punës për punonjësit të cilët nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

2.6 Mbikqyr dhe miraton të gjitha procedurat financiare lidhur me zbatimin e buxhetit të miratuar për Drejtorinë.

2.7 Firmos aktet që DPPM u dërgon zyrove ndërkombëtare në përputhje me parashikimet e marrëveshjeve ndërkombëtare kur DPPM ka statusin e Zyrës së Pranimit, Zyrës së Zgjedhur ose Zyrës së Përcaktuar për aplikimet ndërkombëtare për patenta dhe aplikimet për regjistrimin ndërkombëtar të markave tregëtare dhe të shërbimit ose akteve të tjera që lidhen me to.

2.8 Kryeson Bordin e Apelimit si organ i brendshëm i DPPM.

2.9 Miraton programet dhe planet e trajnimit të punonjësve të DPPM.

2.10 Miraton raportet e vlerësimit të punës të paraqitur nga eprori direkt për secilin punonjës si dhe përcakton mënyrën dhe masën e shpërblimit në bazë të punës së kryer.

2.11 Me propozimin e eprorit direkt, nxjerr urdhër me shkrim për dhënien e masave disiplinore për punonjësit të cilët nuk kryejnë detyrat që i takojnë pozicionit të tyre të punës ose që thyejnë disiplinën e punës ose rregullat e etikës si dhe për shkaqe të tjera të parashikuara nga ligji për statusin e nëpunësit civil ose Kodi i Punës për punonjësit të cilët nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

2.12 Ndan dhe cakton detyrat që duhet të kryejnë punonjësit e DPPM në përputhje me pozicionin e tyre të punës, kontrollon dhe kërkon llogari për kryerjen e detyrave prej tyre.

2.13 Çdo kompetencë dhe detyrë tjetër të parashikuar nga kjo rregullore në kërkeret e tjerë të saj.

KREU IV

DREJTORIA E EKZAMINIMIT, KOORDINIMIT DHE TRAJNIMEVE

1. Kompetencat dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve.

1.1 Kontrollon punën e sektorëve në varësi të tij, firmos të gjitha aktet administrative të lëshuara nga këta sektorë në përmbushje të detyrave funksionale, përveç akteve që sipas kësaj rregulloreje firmosen vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm, nqs është e nevojshme ben veprimet ne IPAS dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm për mbarëvajtjen e punës në këta sektorë;

1.2 Ndjek programet dhe veprimtarinë e projekteve nga grantet e huaja, të donatorëve etj.

1.3 Në bashkëpunim me përgjegjësit e sektorëve në varësi të tij dhe përgjegjësit e sektorëve të tjerë të DPPM, merr pjesë në studimin dhe hartimin e planit strategjik të zhvillimit institucional, si dhe ndjek e merr masa për realizimin e objektivave që përcaktohen në të me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

1.4 Koordinon dhe drejton procesin e hartimit të programeve të kualifikimit të punonjësve të DPPM.

1.5 Organizon dhe mbikëqyr drejtimin, kooperimin dhe bashkëveprimin e punës ndërmjet sektoreve në vartësi, zgjidhjen e problemeve të dala dhe kërkon llogari për zbatimin e detyrave.

1.6 Koordinon dhe drejton hartimin dhe ndjek zbatimin e planit afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit strategjik të sektorëve në varësinë e tij, konform detyrave dhe angazhimeve të përcaktuara në të.

1.7 Harton raportet vjetore të punës dhe planin e punës së Drejtorisë për vitin e ardhshëm dhe ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm.

1.8 Mbikqyr përmbushjen e detyrave nga përgjegjësit e sektorëve në varësi të tij, bën vlerësimin e punës së tyre dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm për shpërblimet, vlerësimet apo masat disiplinore për ta në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.9 Jep informacion për çdo objekt të pronesise industriale subjekteve të interesuara.

1.10 Koordinon takimet e Drejtorit të Përgjithshëm me përfaqësuesit e institucioneve homologe dhe me përfaqësuesit e organizmave ndërkombëtare, si dhe përgatit materialet e nevojshme për këto takime.

1.11 Harton planin periodik dhe vjetor të administrimit të projekteve nga grantet e huaja, të cilat ia paraqet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm dhe përgjigjet për të gjitha veprimet që kryen në kuadrin e administrimit të këtyre projekteve.

1.12 Ndjek dhe kontrollon protokollin e takimeve zyrtare që zhvillohen në drejtori.

KREU V

SEKTORI I PATENTAVE

1. Objekti i veprimtarisë së sektorit

1.1 Sektori i patentave ka si objekt të veprimtarisë së tij: zbatimin e procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008 dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, për shqyrtimin e aplikimeve për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit, të certifikatave të mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, për regjistrimin e topografisë së qarqeve të integruara në bazë të Ligjit Nr. 8488, datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara” ndryshuar me Ligjin Nr. 9957 datë 07.07.2008 si dhe shqyrtimin e aplikimeve të tjera të njohuara nga ligji lidhur me to dhe administrimin e regjistrave të shpikjeve, modeleve të përdorimit dhe regjistrat të topografisë së qarqeve të integruara.

2. Kompetencat dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Patentave

2.1 Përgjegjësi i Sektorit të Patentave është nën varësinë e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve, zbaton me përpikmëri detyrat e caktuara prej tij dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e punës në sektor.

2.2 Me miratimin e Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve u cakton detyra specialistëve të sektorit.

2.3 Përgatit raporte, statistika dhe materiale të tjera informuese që kanë lidhje me veprimtarinë e Sektorit dhe merr pjesë në procesin e hartimit të planeve strategjike të institucionit, përmirësimeve legjislative në fushën e patentave dhe programeve trajnuese për stafin.

2.4 Mbikqyr përmbushjen e detyrave nga specialistët e sektorit, bën vlerësimin e punës së tyre dhe i propozon Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve për shpërblimet, vlerësimet apo masat disiplinore për ta në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.5 Kontrollon kryerjen e hetimeve për patentat nga specialistët e sektorit.

2.6 Kontrollon aktet e përpiluara nga specialistët e sektorit gjatë ekzaminimit të aplikimeve.

2.7 Kontrollon materialin e Buletinit të Pronësisë Industriale për pjesën e patentave, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë.

2.8 Përgatit raportin vjetor dhe planin vjetor të punës për sektorin dhe ia paraqet Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve.

2.9 Përgatit dhe propozon projekte dhe plane për përmirësimin e praktikave të punës së sektorit si dhe për organizimin e aktiviteteve për promovimin e të drejtave të pronësisë industriale.

2.10 Mban korrespondencën me zyrat ndërkombëtare të përcaktuara nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është shtet anëtar dhe me zyrat kombëtare me të cilat Shqipëria ka marrëveshje dypalëshe, për çështje që u takojnë mbrojtjes së patentave, në përputhje me detyrimet e parashikuara në marrëveshjet në fjalë.

2.11 Kryen në IPAS veprimet e parashikuara për përgjegjësin e sektorit.

2.12 Me aprovimin e Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve, jep informacione zyrtare lidhur me patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë.

2.13 Raporton para Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve për realizimin e detyrave nga sektori i patentave sa herë që i kërkohet.

3. Detyrat e specialistëve të sektorit

3.1 Specialisti i Sektorit të Patentave i quajtur më poshtë “ekzaminuesi i patentave”, ka si objekt të veprimtarisë, brenda pozicionit të tij të punës, ekzaminimin e aplikimeve për patentë për shpikje dhe model përdorimi, të aplikimeve për certifikatë të mbrojtjes shtesë, të aplikimeve për regjistrimin e topografisë së qarqeve të integruara si dhe ekzaminimin e aplikimeve të tjera për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e patentave, modeleve të përdorimit dhe regjistrin e topografive të qarqeve të integruara.

3.2 Në përmbushjen e kësaj veprimtarie, ekzaminuesi i patentave kryen detyrat e mëposhtme:

- a) Merr në dorëzim nga protokolli dosjet e aplikimeve për patentë të cilat i janë caktuar atij nga Drejtori i Përgjithshëm ose Përgjegjësi i Sektorit nëse kjo e drejtë i është deleguar me urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm.
- b) Shqyrton nëse dokumentacioni që përmban aplikimi për patentë përmbush kërkesat e Ligjit dhe të rregulloreve dalë në zbatim të tij si dhe verifikon nëse tarifat e paguara nga aplikanti janë në përputhje me VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, megjithë ndryshimet e mëvonshme (kryen ekzaminimin formal të aplikimit).
- c) Në varësi të rezultatit të ekzaminimit, përpilon aktet administrative përkatëse si: njoftimet për plotësimin e të metave të aplikimit, dëshminë e depozitimit, ftesën për pagesën e regjistrimit, njoftimet për refuzimin e aplikimit, patentën dhe çdo akt tjetër të parashikuar nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij.
- ç) Verifikon nëse të dhënat e hedhura në database-in e DPPM (IPAS) për aplikimin që i është caktuar atij për ekzaminim janë të sakta dhe bën korrigjimin e tyre nëse është e nevojshme.
- d) Kryen të gjitha veprimet e parashikuara në IPAS për ekzaminimin e aplikimit që i është caktuar atij.
- dh) Merr në dorëzim nga protokolli dosjet e aplikimeve për certifikatë të mbrojtjes shtesë, ripërtëritje patente, transferim pronësie, regjistrim kontrate license, ndryshim emri ose adrese të pronarit të patentës, dorëheqjes nga patentat, dhe aplikimeve të tjera që kanë lidhje me patentat të cilat i janë caktuar atij, shqyrton nëse dokumentacioni që përmban aplikimi plotëson kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij dhe në varësi të rezultatit të shqyrtimit, përpilon të gjitha aktet administrative të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij.

- e) Merr në dorëzim nga zyra e protokollit dhe shqyrton dokumentat plotësuese të aplikimit të dorëzuara nga aplikanti me iniciativën e tij ose kur kjo i është kërkuar me anë të një njoftimi zyrtar nga DPPM, si dhe verifikon afatet e dorëzimit të tyre.
- ë) Gjatë shqyrtimit të aplikimeve të përmendura më lart, ekzaminuesi i patentave mban përgjegjësi për respektimin e afateve ligjore dhe ndjekjen me përpikmëri të procedurave të ekzaminimit të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij.
- f) Ekzaminuesi i patentave mban përgjegjësi për ligjshmërinë e akteve administrative të përpiluara prej tij gjatë ekzaminimit të aplikimeve që i janë caktuar atij.
- g) Ekzaminuesi i patentave i përpilon aktet administrative të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij në dy kopje, nga të cilat njëra depozitohet në dosje dhe kopja tjetër dorëzohet nga ekzaminuesi në zyrën e protokollit të DPPM. Të gjitha aktet e përpiluara nga ekzaminuesi i patentave në zbatim të procedurave të ekzaminimit të aplikimeve për patentë dhe aplikimeve të tjera lidhur me patentat, të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij, nënshkruhen nga Drejtori i Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve, me përjashtim të patentave të shpikjes, certifikatave të mbrojtjes shtesë, njoftimeve të refuzimit, njoftimeve të skadimit të patentave dhe vendimeve për rivendosjen e të drejtave, të cilat firmosen vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm.
- gj) Përgatit dhe firmos fletën e regjistrimit dhe indeksin e dosjes së aplikimit sipas modelit të përcaktuar dhe dorëzon dosjet në arkivë.
- h) Raporton me shkrim para Përgjegjësit të Sektorit të Patentave për punën e kryer prej tij, sa herë që i kërkohet.

KREU VI

SEKTORI I MARKAVE, DISENJOVE DHE TREGUESVE GJEOGRAFIKË

1. Objekti i veprimtarisë së sektorit

1.1 Sektori i markave, disenjove dhe treguesve gjeografikë ka si objekt të veprimtarisë së tij zbatimin e procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008 dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, për shqyrtimin e aplikimeve për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë dhe regjistrimin e tyre në regjistrat përkatës, shqyrtimin e aplikimeve të tjera të njohuara nga ligji lidhur me to dhe administrimin e regjistrave të markave, disenjove dhe treguesve gjeografikë.

2. Kompetencat dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit

2.1 Përgjegjësi i Sektorit të Markave, Disenjove dhe Treguesve Gjeografikë është nën varësinë e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve dhe zbaton me përpikmëri detyrat e caktuara prej tij dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e punës në sektor.

2.2 Me miratimin e Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve u cakton detyra specialistëve të sektorit.

2.3 Përgatit raporte, statistika dhe materiale të tjera informuese që kanë lidhje me veprimtarinë e Sektorit dhe merr pjesë në procesin e hartimit të planeve strategjike të institucionit, përmirësimeve legislative në fushën e markave, disenjove, treguesve gjeografikë dhe programeve trajnuese për stafin.

2.4 Mbikqyr përmbushjen e detyrave nga specialistët e sektorit, bën vlerësimin e punës së tyre dhe i propozon Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve për shpërblimet, vlerësimet apo për masat disiplinore për ta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.5 Kontrollon aktet e përpiluara nga specialistët e sektorit gjatë ekzaminimit të aplikimeve.

2.6 Kontrollon materialin e Buletinit të Pronësisë Industriale për pjesën e markave, disenjove dhe treguesve gjeografikë.

2.7 Përgatit raportin vjetor dhe planin vjetor të punës për sektorin dhe ia paraqet Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve.

2.8 Përgatit dhe propozon projekte dhe plane për përmirësimin e praktikave të punës së sektorit si dhe për organizimin e aktiviteteve për promovimin e të drejtave të pronësisë industriale.

2.9 Mban korrespondencën me zyrat ndërkombëtare të përcaktuara nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është shtet anëtar dhe me zyrat kombëtare me të cilat Shqipëria ka marrëveshje dypalëshe, për çështje që u takojnë mbrojtjes së markave, disenjove dhe treguesve gjeografikë, në përputhje me detyrimet e parashikuara në marrëveshjet në fjalë.

2.10 Kryen në IPAS veprimet e parashikuara për përgjegjësin e sektorit.

2.11 Me aprovimin e Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve, jep informacione zyrtare lidhur me markat, disenjot dhe treguesit gjeografikë.

2.12 Raporton para Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve për realizimin e detyrave nga sektori i markave sa herë që i kërkohet.

4. Specialistët e sektorit

3.1 Specialisti i Sektorit të Markave, Dizenjove dhe Treguesve Gjeografikë i quajtur më poshtë “ekzaminuesi i markave”, ka si objekt të veprimtarisë, brenda pozicionit të tij të punës, ekzaminimin e aplikimeve për regjistrimin e markave, disenjove dhe treguesve gjeografikë si dhe të aplikimeve të tjera për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrat e markave, të disenjove dhe të treguesve gjeografikë.

3.2 Në përmbushjen e kësaj veprimtarie, ekzaminuesi i markave kryen detyrat e mëposhtme:

- a) Merr në dorëzim nga protokollin dosjet e aplikimeve për regjistrimin e markës/disenjos/treguesit gjeografik të cilat i janë caktuar atij nga Drejtori i Përgjithshëm ose Përgjegjësi i Sektorit nëse kjo e drejtë i është deleguar me urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm.
- b) Shqyrton nëse dokumentacioni që përmban aplikimi për regjistrimin e markës/disenjos/treguesit gjeografik përmbush kërkesat e Ligjit dhe të rregulloreve dalë në zbatim të tij si dhe verifikon nëse tarifat e paguara nga aplikanti janë në përputhje me VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, megjithë ndryshimet e mëvonshme (kryen ekzaminimin formal të aplikimit).
- c) Ekzaminon nëse marka, disenjoja ose treguesi gjeografik përmbush kërkesat për regjistrim të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij (Kryen ekzaminimin për bazat absolute për refuzim).
- ç) Në varësi të rezultatit të ekzaminimit formal dhe ekzaminimit për bazat absolute për refuzim, përpilon aktet administrative përkatëse si: njoftimet për plotësimin e të metave të aplikimit, dëshminë e depozitimit, ftesën për pagesën e regjistrimit, njoftimet për refuzimin e aplikimit, certifikatat e regjistrimit dhe çdo akt tjetër të parashikuar nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij.

- d) Verifikon nëse të dhënat e hedhura në database-in e DPPM (IPAS) për aplikimin që i është caktuar atij për ekzaminim janë të sakta dhe bën korrigjimin e tyre nëse është e nevojshme.
- dh) Kryen të gjitha veprimet e parashikuara në IPAS për ekzaminimin e aplikimit që i është caktuar atij.
- e) Merr në dorëzim nga protokollin dosjet e aplikimeve për ripërtëritje marke ose disenoje, transferim pronësie, regjistrim kontrate license, ndryshim emri ose adrese të pronarit të markës/disenjos/treguesit gjeografik, kufizim liste mallrash, dorëheqje nga marka/disenjoja/treguesi gjeografik dhe aplikimeve të tjera që kanë lidhje me markat, disenjot dhe treguesit gjeografikë të cilat i janë caktuar atij, shqyrton nëse dokumentacioni që përmban aplikimi plotëson kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij dhe në varësi të rezultatit të shqyrtimit, përpilon të gjitha aktet administrative të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij.
- ë) Merr në dorëzim nga zyra e protokollit dhe shqyrton dokumentat plotësuese të aplikimit të dorëzuara nga aplikanti me iniciativën e tij ose kur kjo i është kërkuar me anë të një njoftimi zyrtar nga DPPM, si dhe verifikon afatet e dorëzimit të tyre.
- f) Gjatë shqyrtimit të aplikimeve të përmendura më lart, ekzaminuesi i markave mban përgjegjësi për respektimin e afateve ligjore dhe ndjekjen me përpikmëri të procedurave të ekzaminimit të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij.
- g) Ekzaminuesi i markave mban përgjegjësi për ligjshmërinë e akteve administrative të përpiluara prej tij gjatë ekzaminimit të aplikimeve që i janë caktuar atij.
- gj) Ekzaminuesi i markave i përpilon aktet administrative të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij në dy kopje, nga të cilat njëra depozitohet në dosje dhe kopja tjetër dorëzohet nga ekzaminuesi në zyrën e protokollit të DPPM. Të gjitha aktet e përpiluara nga ekzaminuesi i markave në zbatim të procedurave të ekzaminimit të aplikimeve për markat/disenjot/treguesit gjeografikë të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij, nënshkruhen nga Drejtori i Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve, me përjashtim të certifikatave të regjistrimit dhe ripërtëritjes (për markat, disenjot, treguesit gjeografikë) dhe njoftimeve të refuzimit të aplikimeve, cilat nënshkruhen vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm.
- h) Përgatit dhe firmos fletën e regjistrimit dhe indeksin e dosjes së aplikimit sipas modelit të përcaktuar dhe dorëzon dosjet në arkivë.
- i) Raporton me shkrim para përgjegjësit të Sektorit të Markave për punën e kryer prej tij, sa herë që i kërkohet.

KREU VII

SEKTORI I SHËRBIMEVE

1. Objekti i veprimtarisë dhe struktura organizative

1.1 Sektori i Shërbimeve ka si objekt kryesor të veprimtarisë së tij, sigurimin e mbështetjes logjistike për përmbushjen e aktivitetit kryesor të DPPM nëpërmjet: mbikqyrjes dhe ndjekjes së praktikave të menaxhimit të aktivëve të institucionit në përputhje me legjislacionin përkatës, zbatimin e procedurave dhe praktikave për pranimin në punë të personelit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, mbështetjes dhe asistencës në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe pritjen e aplikimeve dhe regjistrimin e korrespondencës së institucionit me subjektet dhe institucionet e tjera.

1.2 Sektori i Shërbimeve është në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe ka në përbërjen e tij:

- a) Përgjegjës Sektori;
- b) Specialist IT
- c) Arkëtar/ Protokollist;

2. Detyrat dhe kompetencat e Përgjegjës të Sektorit:

2.1 Ka varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtori i Përgjithshëm dhe përgjigjet para tij për realizimin e detyrave të ngarkuara.

2.2 Merr masa për sigurimin e bazës materiale për punonjësit e DPPM dhe kujdeset për administrimin e rregullt të saj.

2.3 Organizon pritjet e delegacioneve të huaja duke u mbështetur në vendimet përkatëse.

2.4 Merr masa për sigurimin e vendit të punës, ndjek zbatimin e orarit të punës dhe rregullave të etikës në punë nga punonjësit e DPPM dhe informon Drejtorin e Përgjithshëm në rast shkelje.

2.5 Në bashkëpunim me sektorët e tjerë të DPPM, siguron të dhënat dhe harton projektplanin e buxhetit, duke përcaktuar saktë nevojat për fonde, sipas klasifikimit të strukturës buxhetore.

2.6 Ndjek realizimin e të ardhurave dhe bën detajimin e tyre sipas udhëzimit të përbashkët me Ministrinë e Financave. Ndjek realizimin e shpenzimeve të institucionit sipas zërave të buxhetit, nxjerr evidencën përkatëse mujore dhe informon Drejtorin e Përgjithshëm.

2.7 Ndjek zbatimin e planit të buxhetit të institucionit, në përputhje me ligjin e miratuar të buxhetit dhe raporton pranë Drejtorit të Përgjithshëm mbi realizimin e tij, sipas evidences së vulosur në thesar.

2.8 Përgatit në fund të çdo muaji listë-prezencën e punonjësve të DPPM dhe listëpagesat për secilin prej tyre.

2.9 Ndjek debi kreditë kur krijohen të tilla.

2.10 Kryen kontrollin periodik të gjendjes së arkës, kontrollon dhe miraton mbajtjen e librit të arkës, derdhjet në arkë dhe veprimet që lidhen me të, të kryera nga arkëtari.

2.11 Mban librin e madh (centralizatori) dhe nxjerr bilancin vjetor kontabël për aktivitetin financiar të institucionit. Bilanci vjetor kontabël miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe dërgohet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2.12 Kujdeset për shlyerjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga antarësimi në Organizatën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelktuale dhe në organizata të tjera ndërkmbëtare.

2.13 Ndjek dhe kontrollon miradministrimin e pasurisë së institucionit, inventarizimin e saj dhe bën sistemimin e diferencave konform legjislacionit në fuqi.

2.14 Ndjek dhe mbikqyr procedurat përkatëse për prokurimin e fondeve të investimeve ose për blerjet konform fondeve të parashikuara në buxhetin e institucionit dhe raporton para Drejtorit të Përgjithshëm lidhur me ecurinë e tyre.

2.15 Kontrollon zbatimin e detyrave për higjenën dhe pastërtinë e ambienteve të punës.

2.16 Kontabilizon veprimet e bankës, arkës në valutë dhe thesarit.

2.17 Kontrollon dhe mbyll brenda afateve shpenzimet për udhëtim e dieta të punonjësve.

2.18 Plotëson dokumentat për pranimin, lëvizjen, transferimin, kualifikimin dhe largimin e personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.19 Zbaton procedurat ligjore dhe rregullat e brendshme për pranimin në punë të personelit.

2.20 Administron dosjet e personelit dhe mban regjistrin qendror të tij. Hedh të dhënat duke rifreskuar, sipas rastit, dosjet personale dhe bën shënimet në librezat e punës së personelit.

2.21 Mbledh dokumentacionin përkatës për personat e emëruar për herë të parë, hap dosjet personale dhe sistemon dosjet ekzistuese.

- 2.22 Ruan konfidencialitetin e veprimeve ndaj personelit deri në vendimin zyrtar sipas rregullave në fuqi.
- 2.23 Harton kontratat e punës dhe plotëson dokumentacionin përkatës për punonjësit e stafit të Drejtorise, marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës.
- 2.24 Përgatit raportin vjetor dhe planin vjetor të punës për sektorin dhe ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm.
- 2.25 Përgatit dhe propozon projekte dhe plane për përmirësimin e praktikave të punës së sektorit.
- 2.26 Mbikqyr përmbushjen e detyrave nga punonjësit e sektorit, bën vlerësimin e punës së tyre dhe informon Drejtorin e Drejtorisë në rastet e shkeljes së disiplinës në punë nga ana e tyre.
- 2.27 Raporton para Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e detyrave nga sektori sa herë që i kërkohet.

3. Detyrat e Sepecialistit IT

- 3.1 Ka varësi të drejtpërdrejtë nga Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve dhe përgjigjet para tij për realizimin e detyrave të ngarkuara.
- 3.2 Parashtron mendime për përmirësimin e rrjetit kompjuterik.
- 3.3 Administron dhe mirëmban rrjetin kompjuterik të brendshëm (LAN), bën kontroll të vazhdueshëm për anomalitë që shfaqen në këtë rrjet, në kompjutera dhe të gjithë aksesoret e tjerë të lidhura në rrjet, si dhe ndihmon në punën e përditshme punonjësit e DPPM për problemet që kanë gjatë përdorimit të programeve të ndryshme të instaluar në kompjuter, internetit dhe e-mailit.
- 3.4 Mban kontakt me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) me qëllim që të sigurojë mbarëvajtjen e shërbimit të internetit, e-mailit zyrtar dhe faqes së internetit të drejtorisë si dhe mirëmban serverat.
- 3.5 Realizon përditësimin e faqes së internetit të DPPM (www.dppm.gov.al) duke formatuar dhe hedhur materialet e reja të përgatitura nga sektorët përkatës.
- 3.6 Administron bazën e të dhënave (IPAS), krijon llogaritë për çdo përdorues, cakton të drejtat e lejuara për çdo përdorues, trajnon personelin e zyrës për përdorimin e sistemit dhe konfiguron sistemin sipas procedurave të parashikuara nga Ligji dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- 3.7 Mban kontakt me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI) për mbarëvajtjen e sistemit (IPAS), bën update-in me versionet e reja të sistemit të mundësuar nga OBPI, si dhe përgatit raportet për ecurinë e sistemit.
- 3.8 Bën back-up të përditshëm të sistemit, për sigurinë e ruajtjes së informacionit.
- 3.9 Në seminare ose takime të organizuara nga DPPM, siguron mbarëvajtjen nga ana e paisjeve të IT si edhe ndihmon në përgatitjen e materialeve të nevojshme.
- 3.10 Përgatit për publikim “Buletinin e Pronësisë Industriale”, bazuar në materialin e dhënë nga sektorët përkatës.
- 3.11 Ofron asistencë teknike për përgatitjen e fletëpalosjeve, broshurave, materialeve të tjera informuese, raporteve dhe statistikave.
- 3.12 Raporton para përgjegjësit të sektorit lidhur me realizimin e detyrave sa herë që i kërkohet.

4. Zyra e Protokollit të DPPM

- 4.1 Protokollisti/arkëtari i DPPM është në varësi të drejtpërdrejtë të Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve dhe ka këto detyra:

- a) Kryen veprimet për pranimin, evidentimin (protokollimin), shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës zyrtare.
- b) Sistemon dhe inventarizon dokumentet që hyjnë ose krijohen brenda institucionit dhe dorëzon në arshivën e Shtetit sipas rregullave të caktuara dokumentat me afat ruajtje të përhershme.
- c) Mban dhe administron regjistrat e protokollit në përputhje me pikën 4 të këtij kreu.
- ç) Mban dhe ruan vulën e institucionit.
- d) Stampon me një vulë të posaçme çdo dokument të paraqitur, duke shënuar datën e marrjes, si dhe vendos numrin e kërkesës në formularin e aplikimit në përputhje me kërkesat e pikës 5 të këtij kreu.
- dh) Hedh në sistemin IPAS disa të dhëna bazë lidhur me çdo kërkesë të paraqitur, si numrin e kërkesës, datën dhe orën e paraqitjes së saj, emrin e përfaqësuesit të autorizuar të patentave kur ka të tillë, llojin e kërkesës së paraqitur etj.
- e) I dërgon paraqitësit të kërkesës dokumentet e dala nga sektoret në të cilat është stampuar data e marrjes dhe numri i kërkesës, si konfirmim për marrjen në dorëzim të kërkesës të paraqitur.
- ë) Kryen të gjitha veprimet që lidhen me pagesat dhe arkëtimet e vlerave monetare sipas ligjeve e vendimeve e udhëzimeve në fuqi.
- f) Plotëson librin e arkës dhe bën kuadrimin mujor me llogarinë.

4.2 Zyra e Protokollit të DPPM mban regjistrat e mëposhtëm:

- a) Regjistri i hyrjes dhe i daljes së korrespondencës zyrtare, të cilët plotësohen nga punonjësi i protokollit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fushën e protokollimit dhe arkivimit të dokumentave në administratën shtetërore.
- b) Regjistri i aplikimeve për patentat. Në këtë regjistër regjistrohen aplikimet e bëra nga subjektet për lëshimin e patentave për shpikjet, modelet e përdorimit, certifikatat e mbrojtjes shitesë ose për regjistrimin e topografive të qarqeve të integruara. Regjistrimi i aplikimeve bëhet duke shënuar në regjistër numrin e protokollit, datën e paraqitjes së aplikimit, titullin e patentës dhe subjektin që ka paraqitur aplikimin. Numri i protokollit u vendoset aplikimeve sipas radhës së paraqitjes së tyre në rend numerik rritës. Regjistri hapet i ri në fillim të çdo viti të ri kalendarik por numri i protokollit vazhdon të numerohet nga numri i fundit i vitit paraardhës. Zyra e protokollit vendos numër të veçantë protokolli vetëm për aplikimin për lëshimin e patentës ndërsa aplikimet e tjera si: ndryshime emri/adrese të pronarit të patentës, ndryshime të pronësisë, kontrata license, ripërtëritje të patentës, apelime, kundërshtime etj., çdo dokument tjetër që paraqitet nga subjekti lidhur me të si dhe çdo njoftim apo akt tjetër administrativ i lëshuar nga DPPM lidhur me të njëjtën patentë, regjistrohen me të njëjtin numër protokolli, duke marrë fraksione në rend numerik rritës, sipas radhës së hyrjes apo daljes së tyre.
- c) Regjistri i aplikimeve për disenjot industriale. Në këtë regjistër regjistrohen aplikimet e bëra nga subjektet për regjistrimin e disenjove industriale. Regjistrimi i aplikimeve bëhet duke shënuar në regjistër numrin e protokollit, datën e paraqitjes së aplikimit, emërtimin e disenjës dhe subjektin që ka paraqitur aplikimin. Numri i protokollit u vendoset aplikimeve sipas radhës së paraqitjes së tyre në rend numerik rritës. Regjistri hapet i ri dhe fillon me numër rendor 1(një) në fillim të çdo viti të ri kalendarik. Zyra e protokollit vendos numër të veçantë protokolli vetëm për aplikimin për regjistrimin e disenjës ndërsa aplikimet e tjera si: ndryshime emri/adrese të pronarit të disenjës, ndryshime të pronësisë, kontrata license,

ripërtëritje të disenjos, apelime, kundërshtime etj., çdo dokument tjetër që paraqitet nga subjekti lidhur me të, si dhe çdo njoftim apo akt tjetër administrativ i lëshuar nga DPPM lidhur me të njëjtën diseno, regjistrohen me të njëjtin numër protokollit, duke marrë fraksione në rend numerik rritës, sipas radhës së hyrjes apo daljes së tyre.

ç) Regjistri i aplikimeve për markat. Në këtë regjistër regjistrohen aplikimet e bëra nga subjektet për regjistrimin e markave. Regjistrimi i aplikimeve bëhet duke shënuar në regjistër numrin e protokollit, datën e paraqitjes së aplikimit, emërtimin e markës dhe subjektin që ka paraqitur aplikimin. Numri i protokollit u vendoset aplikimeve sipas radhës së paraqitjes së tyre në rend numerik rritës. Regjistri hapet i ri dhe fillon me numër rendor 1(një) në fillim të çdo viti të ri kalendarik. Zyra e protokollit vendos numër të veçantë protokollit vetëm për aplikimin për regjistrimin e markës ndërsa aplikimet e tjera si: ndryshime emri/adrese të pronarit të markës, ndryshime të pronësisë, kontrata license, ripërtëritje të markës, apelime, kundërshtime etj. , çdo dokument tjetër që paraqitet nga subjekti lidhur me të si dhe çdo njoftim apo akt tjetër administrativ i lëshuar nga DPPM lidhur me të njëjtën markë, regjistrohen me të njëjtin numër protokollit, duke marrë fraksione në rend numerik rritës, sipas radhës së hyrjes apo daljes së tyre.

d) Regjistri i aplikimeve për treguesit gjeografikë. Në këtë regjistër regjistrohen aplikimet e bëra nga subjektet për regjistrimin e treguesve gjeografikë. Regjistrimi i aplikimeve bëhet duke shënuar në regjistër numrin e protokollit, datën e paraqitjes së aplikimit, emërtimin e treguesit gjeografik dhe subjektin që ka paraqitur aplikimin. Numri i protokollit u vendoset aplikimeve sipas radhës së paraqitjes së tyre në rend numerik rritës. Regjistri hapet i ri dhe fillon me numër rendor 1(një) në fillim të çdo viti të ri kalendarik. Zyra e protokollit vendos numër të veçantë protokollit vetëm për aplikimin për regjistrimin e treguesit gjeografik ndërsa aplikimet e tjera si: ndryshime emri/adrese të pronarit, apelime, kundërshtime etj., çdo dokument tjetër që paraqitet nga subjekti lidhur me të si dhe çdo njoftim apo akt tjetër administrativ i lëshuar nga DPPM lidhur me të njëjtin tregues gjeografik, regjistrohen me të njëjtin numër protokollit, duke marrë fraksione në rend numerik rritës, sipas radhës së hyrjes apo daljes së tyre.

dh) Libri i brendshëm i dorëzimit është regjistri që mbahet nga punonjësi i protokollit, ku shënohet lëvizja e dokumentave brenda institucionit. Marrja në dorëzim për ndjekje, nga punonjësit e DPPM, të aplikimeve apo dokumentave të tjera zyrtare të protokolluara bëhet vetëm kundrejt firmosjes në librin e dorëzimit.

e) Libri i jashtëm i dorëzimit është regjistri ku punonjësi i protokollit regjistron datën e daljes së dokumentave nga institucioni, të dhënat e personit që merr në dorëzim dokumentin dhe nënshkrimin e tij.

4.3 Regjistrave të protokollit, në momentin e hapjes së tyre, duhet t'iu numërtohen fletët dhe të vulosen nga punonjësi i protokollit dhe në fund të çdo viti, mbahen procesverbalet e mbylljes së tyre, të cilët firmosen nga punonjësi i protokollit dhe Drejtori i Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve. Ky rregull nuk vlen për librat e dorëzimit.

4.4 Korrigjimi i gabimeve në regjistrat e protokollit bëhet duke vendosur në kllapa gabimin e bërë dhe duke hedhur në vijim të dhënat e sakta, me qëllim që gabimi i bërë të jetë i dukshëm.

5. Trajtimi i korrespondencës nga Zyra e Protokollit

5.1 Dokumentet që hyjnë në adresë të institucionit hapen, protokollohen dhe i përcillen Drejtorit të Përgjithshëm. Shpërndarja e tyre për ndjekje nga strukturat përkatëse, bëhet konform shënimit të Drejtorit të Përgjithshëm, kundrejt konfirmimit me shkrim të marrësit në dorëzim.

5.2 Zyra e protokollit pranon aplikimet për lëshimin e patentave dhe aplikimet për regjistrimin e disenjove industriale, markave dhe treguesve gjeografikë të paraqitura pranë DPPM. Në momentin e marrjes në dorëzim të aplikimit, punonjësi i protokollit shënon mbi formularin e aplikimit elektronikisht (nga sistemi IPAS), datën dhe orën e paraqitjes së aplikimit, numrin e protokollit në përputhje me parashikimet e pikës 4.1 të këtij kreu dhe numrin e kërkesës si më poshtë:

- a) Për patentat, numri i kërkesës shënohet: AL-P-viti aktual-numri i protokollit (i vendosur në përputhje me pikën 4.1 gërma “b” e këtij kreu).
- b) Për disenjt, numri i kërkesës shënohet: AL-I-viti aktual-numri i protokollit (i vendosur në përputhje me pikën 4.1, gërma “c” e këtij kreu).
- c) Për markat, numri i kërkesës shënohet: AL-T-viti aktual-numri i protokollit (i vendosur në përputhje me pikën 4.1 gërma “ç” e këtij kreu).
- ç) Për treguesit gjeografikë, numri i kërkesës shënohet: AL-G-viti aktual-numri i protokollit (i vendosur në përputhje me pikën 4.1 gërma “d” e këtij kreu).

5.3 Zyra e protokollit të DPPM pranon gjithashtu aplikimet e tjera lidhur me patentat, disenjt, markat dhe treguesit gjeografikë, të parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij si: aplikimet për ndryshim emri/adrese të pronarit, ndryshim pronësie, regjistrim kontrate license, ripërtëritje, apelime, kundërshtime etj. Në momentin e marrjes në dorëzim të këtyre aplikimeve, punonjësi i protokollit shënon elektronikisht (nga sistemi IPAS) mbi formularin e aplikimit datën dhe orën e paraqitjes së aplikimit, llojin e aplikimit, numrin e kërkesës së patentës, disenjos, markës apo treguesit gjeografik për të cilin është bërë aplikimi si dhe numrin e protokollit i cili vendoset me fraksion, në përputhje me parashikimet e pikës 4.1 të këtij kreu.

5.4 Punonjësi i protokollit ia paraqet dosjet e aplikimeve për lëshimin e patentave apo për regjistrimin e disenjove, markave dhe treguesve gjeografikë si dhe dosjet e aplikimeve të tjera lidhur me to, Drejtorit të Përgjithshëm, i cili shënon mbi formularin e aplikimit, emrin e ekzaminuesit që do të ekzaminojë dosjen. Dosjet iu dorëzohen ekzaminuesve të caktuar nga punonjësi i protokollit, kundrejt nënshkrimit në librin e dorëzimit.

5.5 Dokumentet plotësuese të paraqitura nga subjektet lidhur me aplikimet për patenta, disenjo, marka ose tregues gjeografikë, merren në dorëzim nga punonjësi i protokollit, i cili shënon mbi dokument elektronikisht (nga sistemi IPAS), datën dhe orën e paraqitjes së dokumentit, llojin e dokumentit, numrin e kërkesës së patentës, disenjos, markës apo treguesit gjeografik për të cilin depozitohet dokumenti si dhe numrin e protokollit në përputhje me parashikimet e pikës 4.1 të këtij kreu. Dokumentet plotësuese të një aplikimi i dorëzohen ekzaminuesit të cilit i është caktuar ekzaminimi i aplikimit, kundrejt nënshkrimit në librin e dorëzimit.

5.6 Njoftimet dhe aktet e tjera administrative të lëshuara nga DPPM lidhur me aplikimet për patenta, disenjo, marka dhe tregues gjeografikë, protokollohen në përputhje me pikën 4.1 të këtij kreu dhe i dorëzohen aplikantit ose përfaqësuesit të tij kundrejt nënshkrimit në librin e jashtëm të dorëzimit.

5.7 Çdo lloj korrespondence zyrtare që del nga DPPM dhe i drejtohet Presidentit të Republikës, Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrit dhe zyrave të tyre, ministrave dhe drejtuesve të institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera qendrore dhe vendore si dhe organizmave ndërkombëtare, do të firmosen vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPM. Korrespondenca që iu drejtohet subjekteve që kanë paraqitur aplikime për objektet e pronësisë industriale pranë DPPM, firmoset nga punonjësit e parashikuar nga kjo rregullore si dhe nga Drejtori i Përgjithshëm. Zyra e protokollit nuk duhet të vendosë vulën në asnjë rast që shkelet ky rregull. Përgjithësi mund të bëhet me autorizim të veçantë me shkrim të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm, ku duhet të përcaktohet dokumenti dhe personi që do të firmosë, me porosi të tij.

KREU VIII SEKTORI JURIDIK

1. Objekti i veprimtarisë dhe struktura organizative

1.1 Sektori Juridik ka si objektiv kryesor të veprimtarisë së tij, të sigurojë që praktikat e punës së sektorëve të tjerë janë në përputhje me procedurat e parashikuara nga Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008, aktet nënligjore dalë në zbatim të tij dhe marrëveshjet ndërkombëtare të fushës si dhe të asistojë sektorët e tjerë në kuptimin dhe interpretimin e saktë të legjislacionit përkatës gjatë përmbushjes së detyrave të tyre funksionale.

1.2 Sektori Juridik është në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe ka në organikën e tij:

- a) Përgjegjësin e Sektorit;
- b) Specialist regjistri;
- c) Specialist.

2. Detyrat dhe kompetencat e Përgjegjësit të Sektorit

2.1 Ka varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtori i Përgjithshëm, zbaton me përpikmëri detyrat e caktuara prej tij dhe përgjigjet para tij për detyrat e ngarkuara.

2.2 Asiston me ndihmë juridike drejtpërsëdrejti Drejtorin e Përgjithshëm të DPPM duke dhënë mendime juridike dhe duke përpiluar shkresa dhe akte të tjera administrative të kërkuara prej tij.

2.3 Trajton çështje konkrete juridike, të cilat i përcillen për shqyrtim nga Drejtori i Përgjithshëm dhe raporton para tij për përfundimin apo për probleme që lidhen me procesin e shqyrtimit të tyre.

2.4 Bën propozime për ndryshime apo përmirësime në aktet ligjore apo nënligjore, kur gjykon se ato bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi.

2.5 Me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm, përfaqëson DPPM në të gjitha shkallët e gjykimit.

2.6 Bën trajtimin juridik të korrespondencës zyrtare që ka të bëjë me punën e Sektorit.

2.7 Studion e paraqet propozime për hartimin e ligjeve, akteve nënligjore e udhëzimeve që kanë të bëjnë me përsosjen e sistemit të pronësisë industriale.

2.8 Ndjek punën për sigurimin e akteve ligjore, nënligjore e normative të botuara në fletoren zyrtare dhe shpërndarjen e tyre për çdo sektor si dhe ofron asistencë ligjore në hartimin e praktikave të punës të sektorëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.9 Përgatit raportin vjetor dhe planin vjetor të punës për sektorin dhe ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm.

2.10 Përgatit dhe propozon projekte dhe plane për përmirësimin e praktikave të punës së sektorit.

2.11 Merr pjesë dhe asiston në përgatitjen e marrëveshje dypalëshe në fushën e pronësisë industriale me zyra homologe të vendeve të tjera si dhe në përgatitjen e protokolleve të bashkëpunimit me institucione të tjera shqiptare.

2.12 Mbikqyr përmbushjen e detyrave nga specialistët e sektorit, bën vlerësimin e punës së tyre dhe informon Drejtorin e Drejtorisë në rastet e shkeljes së disiplinës në punë nga ana e tyre.

2.13 Përgatit në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit, njoftimet për Zyrën Ndërkombëtare në rastet e refuzimit, zhvlerësimit, pavlefshmërisë ose kundërshtimeve të depozituara për markat ndërkombëtare.

2.14 Raporton para Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin e detyrave nga sektori sa herë që i kërkohet.

3. Detyrat e specialistit të sektorit

3.1 Specialisti i Sektorit Juridik është në varësinë e drejtpërdrejtë të përgjegjësit të sektorit dhe zbaton me përpikmëri detyrat e ngarkuara prej tij.

3.2 Specialisti i sektorit mund të kryejë secilën nga detyrat e parashikuara nga pika 2.2 deri në 2.8 si dhe pikat 2.10, 2.11 dhe 2.13 të këtij kreu, kur këto i caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

3.3 Specialisti i sektorit kryen edhe detyrat e mëposhtme:

a) Merr pjesë në mbledhjet e Drejtorisë dhe mban shënimet e mbledhjes;

b) Përgatit programet e punës në rast seminari apo takimi me grupet e interesit, përfaqësuesit e autorizuar apo ekspertët e huaj.

c) Asiston përgjegjësën e sektorit në përmbushjen e detyrave dhe objektivave të sektorit.

ç) Kryen detyra të tjera që i caktohen nga përgjegjësi i sektorit ose Drejtori i Përgjithshëm.

4. Specialisti i regjistrit

4.1 Specialisti i regjistrit është në varësinë direkte të përgjegjësit të sektorit juridik dhe ka si objekt të punës së tij, hedhjen dhe sistemimin e të dhënave në regjistrat e patentave, markave, disenjove, treguesve gjeografikë dhe përfaqësuesve të autorizuar, administrimin e arkivave të DPPM si dhe lëshimin e dokumentave për palët e treta që kërkojnë informacion nga regjistrat ose arkivat në përputhje me parashikimet e Ligjit dhe rregulloreve dalë në zbatim të tij.

4.2 Në përmbushje të objektit të veprimtarisë së tij, specialisti i regjistrit kryen këto detyra:

a) Hap faqet e reja të regjistrave të patentave, markave, disenjove, treguesve gjeografikë dhe përfaqësuesve të autorizuar që regjistrohen pranë DPPM.

b) Hedh në faqen përkatëse të regjistrit të gjitha ndryshimet që pëson një patentë, markë, disenjo apo tregues gjeografik i regjistruar sipas rendit kronologjik të tyre.

c) Shqyrton kërkesat për lëshim ekstrakti nga regjistrat e patentave, markave, disenjove dhe treguesve gjeografikë të depozituara pranë DPPM nëse janë në përputhje me kërkesat e

- parashikuara nga Ligjit dhe rregulloret dalë në zbatim të tij, dhe përpilon ~~e nënshkruan~~ dokumentin e ekstraktit të regjistrit.
- ç) Shqyrton kërkesat për hetim të depozituara pranë DPPM nëse janë në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Ligjit dhe rregulloret dalë në zbatim të tij, kryen hetimet për markat kombëtare dhe ndërkombëtare, disenjot dhe treguesit gjeografikë dhe përpilon aktin për përgjigjen e hetimit.
 - d) Mban regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar të licensuar dhe bën ndryshimet në të.
 - dh) Mban regjistrin e markave ndërkombëtare të regjistruara nëpërmjet Marrëveshjes së Madridit.
 - e) Hedh në regjistrin e markave ndërkombëtare të gjitha ndryshimet që pësojnë ato.
 - ë) Merr në dorëzim dosjet e aplikimeve të përfunduara nga ekzaminuesit e Sektorit të Patentave dhe ekzaminuesit e Sektorit të Markave, Disenjove dhe Treguesve Gjeografikë, pasi kontrollojnë përmbajtjen e dosjes sipas indeksit si dhe plotëson në të pjesën që i takon specialistit të regjistrit, dhe mban përgjegjësi për ruajtjen e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat në insitucionet shtetërore.
 - f) Kryen veprimet për evidentimin dhe pranimin e dokumentave të sjella nga ekzaminuesit e patentave dhe markave.
 - g) Përgatit listën e veçimit të dokumentave të arkivës për të cilat kanë kaluar afatet e ruajtjes.
 - gj) Shqyrton kërkesat për lëshim dublikate nga dosjet e patentave, markave, disenjove dhe treguesve gjeografike, nëse janë në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe rregulloret dalë në zbatim të tij, dhe përpilon aktin për lëshimin e dublikatës.
 - h) Specialisti i regjistrit mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e akteve të përpiluara prej tij. Aktet e përpiluara nga specialisti i regjistrit nënshkruhen nga Drejtori i Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve.
 - i) Inspektimi i regjistrave të patentave/markave/disenjove/treguesve gjeografikë dhe dosjeve të aplikimeve të dorëzuara në arkivë si dhe fotokopjimi i tyre bëhet vetëm me autorizim me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPM.

KREU IX BORDI I APELIMIT TË DPPM

1. Mënyra e krijimit dhe struktura

1.1 Bordi i apelimit është një strukturë e brendshme dhe permanente e DPPM që krijohet me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm dhe e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, të përmendura në pikën 1.2 të Kreut I të kësaj rregulloreje.

1.2 Bordi i apelimit përbëhet nga tre antarë, nga të cilët njëri është kryetar i bordit. Kryetar i bordit të apelimit është Drejtori i Përgjithshëm i DPPM. Antarët e tjerë të bordit emërohen dhe shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

1.3 Bordi i apelimit ka në përbërjen e tij të paktën një jurist, i cili është përgjegjës për përpilimin e akteve administrative që nxjerr bordi gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij të përcaktuar nga ligji. Në rast se bordi i apelimit ka në përbërjen e tij më shumë se një jurist, kryetari i bordit cakton antarin e bordit përgjegjës për përpilimin e akteve që lëshon bordi.

2. Mënyra e funksionimit të bordit

2.1 Bordi i apelimit shqyrton aplikimet e apelimit kundër vendimeve për refuzim të marra nga ekzaminuesit e patentave dhe markave, kundërshtimet e depozituara nga palët e treta ndaj një patente, disenoje, marke ose treguesi gjeografik dhe çdo aplikim tjetër, shqyrtimi i të cili është në kompetencën e bordit të apelimit, sipas ligjit dhe rregulloreve dalë në zbatim të tij.

2.2 Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij ligjore, bordi i apelimit lëshon njoftime ose vendime.

a) njoftimet janë akte administrative të nxjerra nga bordi i apelimit të cilat u drejtohen palëve pjesëmarrëse në procedurën e apelimit ose kundërshtimit, me qëllim plotësimin e të metave të aplikimit, depozitimin e dokumentave dhe shpjegimeve të nevojshme për shqyrtimin e aplikimit ose paraqitjen e palëve para bordit për dhënien e shpjegimeve me gojë.

b) vendimet janë aktet administrative të nxjerra nga bordi i apelimit të cilat i japin zgjidhje në themel apelimit ose kundërshtimit të depozituar për shqyrtim. Vendimi i bordit në çdo rast duhet të përmbajë të dhënat për palët pjesëmarrëse në procedurën e shqyrtimit, bazën ligjore dhe arsyetimin se ku mbështetet vendimi i marrë dhe shpjegime rreth të drejtës së palëve për të apeluar ose jo në gjykatë.

2.3 Aktet e nxjerra nga bordi i apelimit nënshkruhen nga të tre antarët e tij dhe u dërgohen të gjitha palëve pjesëmarrëse në procedurën e shqyrtimit. Një kopje e tyre ruhet në dosjen e aplikimit.

2.4 Bordi i apelimit i merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash. Antari i bordit që nuk është dakord me vendimin e shumicës, ka të drejtë të mos firmosë vendimin e bordit dhe të depozitojë në dosje mendimin e tij me shkrim.

2.5 Në rastin kur palët thirren për të dhënë shpjegime me gojë para bordit, është e detyrueshme mbajtja e një procesverbali me shkrim, ku të shënohen të dhënat rreth pjesëmarrësve në procedim, shpjegimet e bëra nga palët dhe vendimet e marra në përfundim të procedurës. Procesverbali mbahet nga njëri prej antarëve të bordit dhe duhet të firmoset nga të gjithë antarët e tij. Nëse në përfundim të procedurës gojore është marrë një vendim, vendimi duhet të zbardhet, të firmoset nga antarët e bordit dhe t'u dërgohet palëve të interesuara.

2.6 Antari i bordit të apelimit që ka një konflikt interesi në shqyrtimin e një aplikimi paraqitur bordit, ka të drejtë t'i kërkojë me shkrim kryetarit të bordit dorëheqjen nga procedura e shqyrtimit. Kur kryetari i bordit e pranon dorëheqjen, ai cakton me urdhër të brendshëm një zëvendësues të tij, vetëm për këtë çështje.

2.7 Bordi gjatë shqyrtimit të aplikimeve për apelim ndaj një vendimi për refuzim të lëshuar nga DPPM, ka të drejtë t'i kërkojë ekzaminuesit të aplikimit të refuzuar, një relacion me shkrim lidhur me procedurën e ndjekur prej tij gjatë ekzaminimit dhe arsyet e refuzimit.

KREU X

LICENSIMI I PËRFAQËSUESVE TË AUTORIZUAR NGA DPPM

1. Testimi kualifikues i përfaqësuesve të autorizuar

1.1 DPPM licenson përfaqësuesit e autorizuar të patentave dhe përfaqësuesit e autorizuar të markave, për të ushtruar aktivitetin si përfaqësues profesionistë të subjekteve të cilat kërkojnë të regjistrojnë pranë DPPM objekte të pronësisë industriale.

1.2 Licensimi i përfaqësuesve të autorizuar dhe regjistrimi i tyre në regjistrin përkatës të DPPM bëhet pasi kandidatët e paraqitur kualifikohen në testimin e organizuar për këtë qëllim nga DPPM. Në testimin kualifikues mund të marrin pjesë vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e nenit 197 të Ligjit.

1.3 Testimi kualifikues për përfaqësuesit e autorizuar është i hapur dhe organizohet në përputhje me kërkesat e aplikimeve. Më tej aplikantët njoftohen për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të testimit si dhe afatin brenda të cilit kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin dhe të bëjnë pagesën e tarifës përkatëse.

1.4 Kandidatët e interesuar për të marrë pjesë në testimin kualifikues, duhet të paraqesin pranë DPPM, një kërkesë me shkrim për pjesëmarrjen në testim, të shoqëruar me dokumentat të cilat vërtetojnë se ata i plotësojnë kriteret e nenit 197 të Ligjit, si dhe mandat-pagesën e tarifës për pjesëmarrjen në testim.

1.5 Testimi për kandidatët të cilët kërkojnë të licensohen si përfaqësues të autorizuar të patentave apo të markave, dizenjove dhe emertimeve të origjines zhvillohet pranë Komisionit të Vlerësimit të krijuar me urdhër të vecantë nga Drejtori i Përgjithshëm.

1.6 Testimi kualifikues për përfaqësuesit e autorizuar zhvillohet me shkrim ose me gojë në varësi të vendimit që merr Komisioni i Vlerësimit.

2. Komisioni i vlerësimit

2.1 Komisioni i vlerësimit për testimin e përfaqësuesve të autorizuar përbëhet nga 3 antarë, prej të cilëve njëri është kryetar i komisionit. Komisioni krijohet me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm.

2.2 Brenda një muaji nga data e zhvillimit të testimit, komisioni duhet të bëjë vlerësimin dhe të marrë vendimin përkatës. Komisioni shqyrton fillimisht dosjet e kandidatëve, nëse ata i plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 197 i Ligjit. Nëse kandidatët nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u licensuar si përfaqësues të autorizuar, ata skualifikohen dhe komisioni nuk e merr në shqyrtim aplikimin.

2.3 Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjeve të paraqitura nga pjesëmarrësit në testim, komisioni procedon me vlerësimin e testimit për kandidatët e kualifikuar.

2.4 Komisioni i vlerësimit mban një procesverbal me shkrim ku pasqyrohet i gjithë procesi i vlerësimit. Procesverbali firmoset nga të gjithë antarët e komisionit.

2.5 Në përfundim të procesit të vlerësimit, komisioni del me një vendim i cili duhet të përmbajë kandidatët që kualifikohen, kandidatët që nuk kalojnë testimin si dhe personat e skualifikuar. Për kandidatët që nuk kalojnë testimin si dhe për personat e skualifikuar jepen edhe arsyet përkatëse.

2.6 Personat të cilët kalojnë me sukses testimin, pasi kryejnë pagesën e tarifës përkatëse, regjistrohen në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar dhe pajisen me licensën përkatëse.

2.7 DPPM mban regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar të patentave dhe regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar të markave. Secili prej përfaqësuesve të autorizuar ka një fletë të veçantë regjistri, ku shënohen të dhënat e tij të kontaktit dhe numri i identifikimit.

3. Ripërtëritja e licensës së përfaqësuesit të autorizuar

3.1 Licensa e dhënë nga DPPM për përfaqësuesit e autorizuar mund të ripërterihet brenda 5 vjetëve nga data e lëshimit të saj. Përfaqësuesit e autorizuar, të cilët janë të interesuar të ripërtërijnë licensën, duhet të bëjnë kërkesë me shkrim pranë DPPM, si dhe të bëjnë pagesën e tarifës për regjistrimin e përfaqësuesve të autorizuar në regjistrin e DPPM.

Kërkesat e paraqitura pas afatit 5 vjecare do të konsiderohen si kërkesa fillestare.

3.2 Një përfaqësuesi të autorizuar, të licensuar nga DPPM mund t'i hiqet licensa kur, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij si përfaqësues, kryen shkelje të ligjit ose të etikës profesionale. Në këtë rast, krijohet me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, një komision i veçantë i përbërë nga tre antarë dhe i kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPM. Komisioni pasi shqyrton faktet, merr një vendim, i cili duhet të jetë i arsyetuar.

KREU XI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e DPPM. Moszbatimi i kësaj rregulloreje nga punonjësit e DPPM, konsiderohet shkelje disiplinore dhe shoqërohet me masa disiplinore të përcaktuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil dhe kontratën e punësimit.

2. Rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të DPPM, miratuar me Urdhërin Nr. 406 datë 06.05.2009 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shfuqizohet.

3. Kjo Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të DPPM hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

FLORJON MIMA

Z. Lako është diplomuar në vitin 1999 në Universitetin e Tiranës , Fakulteti i Drejtësisë

Në karrierën e tij të mëparshme ka ushtruar detyrën si Avokat pranë zyrës ligjore “Lako&Law”. Detyra të mëparshme në administratën publike Z. Lako në periudhën Dhjetor 2005 –Shkurt 2006 ka mbajtur rolin e inspektorit në Departamentin të Kontrollit të Brëndshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit pranë Këshillit të Ministrave, ndërsa në periudhën Mars 2002 –Dhjetor 2005 ka ushtruar detyrën e Juristit në Departamentin Juridik po në Këshillin e Ministrave. Në periudhën Janar 2001 – Korrik 2001 Z. Lako ka mbajtur rolin e Përgjegjës të Zyrës Juridike në Ministrinë Kulturës , Rinisë dhe Sporteve, ndërsa gjatë periudhës Shtator 2001 – Mars 2002 ka mbajtur rolin e Këshilltarit të Minsitrit të Mbrojtjes.

Gjithashtu Z. Lako në angazhime të tjera ka marrë pjesë si Konsulent në projektin e trajnimit të kontabilistëve në sektorin publik (CBIPA, moduli i ligjit vendas, 2005). Trajner në programin për nëpunësit e sapoemëruar në shërbimin civil, të organizuar nga ITAP. Anëtar i Komitetit të Auditimit pranë ministrit të Financave, në 2005- 2006. Anëtar i Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim, në 2004 e vazhdim. Anëtar i Inspektoratit të Ulët të Deklarimit të Pasurive në Kryeministri, në 2004 - 2005. Këshilltar i jashtëm i ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në 2002. Anëtar i Grupit Negociator me WTO (Organizata Botërore e Tregtisë), në 2001. Anëtar i grupit të punës për përafrimin e legjislacionit me EU, në 2001. Kryetar i Këshillit Mbikqyrës “Qendra e Llotarive Sportive” sh.a, në 2001. Anëtar i grupeve të ndryshme pune për hartimin e disa projektligjeve të rëndësishme. Ai zotëron shumë mirë gjuhët angleze, italiane.